

AUTONOMIA

PUBLIKIM I SHOQATËS PËR AUTONOMINË VENDORE

VENDORE



autonomia
vendore



demokracia
lokale



decentralizimi



rritja e
kapaciteteve




zhvillimi
lokal



mbrojtja e
mjedisit



SHOQATA
PER AUTONOMINE
VENDORE



Falenderojmë ekipin e Shoqatës për Autonomi Vendore (SHAV), bashkitë dhe partnerët tanë kryesorë, donatorët dhe ekspertët, dhe aktorët e tjerë të pushtetit vendor, të cilët me përfshirjen dhe mbështetjen e tyre në veprimtarinë sektoriale të shoqatës kanë kontribuar në mundësimin e kësaj broshure.

Na kontaktoni:



Rruga Reshit Çollaku, Pallati 38 shkalla
2 ap. 13/1, Tiranë, Shqipëri




info@shav.al



www.shav.al




@shoqataperautonomivendore




autonomia_vendore

PËRMBAJTJA

Rreth Nesh	02
Editorial	04
Decentralizimi	05
Rritja e Kapaciteteve	06
Përfshirja Sociale	07
Zhvillimi i Biznesit Lokal	08
Mbështetja Komunitare	09
Mjedisi Lokal	10
Bashkëpunimi Ndërkombëtar	11
Raporte	13
Anëtarët	15
Partnerët	16





**SHKËMBIM PËRVOJASH ME SHOQATAT HOMOLOGUE TË RAJONIT
SHTËPIA STUDIO KADARE**

NËNTOR 2022

RRETH NESH

Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV) u themelua në 12 Janar 2010, si një bashkim vullnetar dhe i pavarur i Bashkive të Republikës së Shqipërisë, me misionin për më shumë autonomi vendore përmes forcimit e zhvillimit të strukturave dhe mekanizmave demokratik në organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore.



Vizioni i SHAV mbetet forcimi i të drejtave dhe lirive të këtyre Njësive si një parakusht për zgjidhjen e problemeve të komuniteteve lokale, duke qënë më pranë tyre përmes gjithëpërfshirjes dhe kompetencave në vendimmarrje.

Na kontaktoni:



Rruga Reshit Çollaku, Pallati 38 shkalla
2 ap. 13/1, Tiranë, Shqipëri



info@shav.al



www.shav.al



@shoqataperautonomivendore



autonomia_vendore



AKTIVITET ME KOMUNITETIN NË ZONAT RURALE
MALI I VELEËS
QERSHOR 2022

EDITORIAL

I dashur lexues,

Kam kënaqësinë që në këtë fundviti t'ju prezantojë me numrin më të fundit të buletinit periodik të Shoqatës për Autonominë Vendore, një përmbledhje të veprimtarisë së Shoqatës sonë gjatë gjysmës së dytë të 2022, e cila shpalos axhendën e ngjeshur të aktiviteteve tona në funksion të misionit organizativ për të mbështetur pushtetin lokal dhe zhvillimin e komunitetit të çdo bashkie në vend.

Ky material i adresohet të gjithë aktorëve kryesor të pushtetit vendor, përfshirë pushtetin qendror dhe ligjvënësit tanë, bashkitë e veçanërisht kryebashkiakët e tyre, agjencitë publike, shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtar dhe donatorët, biznesin, akademinë dhe ekspertët, grupet e marginalizuara, komunitetet lokale, median dhe publikun e gjërë, për të cilët gjejmë rastin t'i falenderojmë për mbështetjen, kontributin dhe bashkëpunimin e treguar përgjatë të gjithë rrugëtimit tonë.

Në këtë numër lexuesi ka mundësi të njihet me disa prej tematikave kryesore që SHAV është angazhuar në 6 muajt e fundit, ku trajtohen aktivitete dhe veprimtari që përfshijnë: procesin e decentralizimit, rritjen e kapaciteteve, përfshirjen sociale, zhvillimin e biznesit lokal, mbështetjen komunitare, mjedisin lokal, bashkëpunimet ndërkombëtare si dhe projektet dhe raportet më të fundit të prodhuar nga SHAV.

Këto janë vetëm disa prej temave kryesore të cilat përmbledhin copëzat e "puzzle"-it të misionit tonë, një sipërmarrje sfiduese për arritjen e objektivave tanë strategjik, ku qëllimi kryesor është mundësimi i autonomisë vendore në funksion të lehtësimit të shërbimeve publike dhe rritjes ë cilësisë së jetës për çdo anëtar të komunitetit.

Së fundi, krahas ftesës sonë për t'u njohur më shumë rreth aktivitetit tonë mirëpresim gjithashtu të na përcillni komentet dhe sugjerimet tuaja, përmes kontributit tuaj civil e profesional, sesi dita-ditës së bashku të mund të përmirësohemi dhe zhvillohemi më tej.

Duke ju falenderuar për kohën tuaj, gjej rastin që në emër të Shoqatës për Autonomi Vendore t'ju përcjellim urimet më të sinqerta për festat e fundvitit. Sot e Mot, GËZUAR 2023!

Përzemërsisht,

Adelina
Farrici



ADELINA FARRICI
DREJTORE EKZEKUTIVE
SHOQATA PËR AUTONOMI VENDORE



DECENTRALIZIMI

#Strategjia e Re e Decentralizimit 2023-2030

Shoqata për Autonominë Vendore (SHAV) me mbështetjen e projektit zviceran “Bashki të Forta” zhvillojë për 3 muaj me radhë fushatën e konsultimit publik në kuadër të hartimit të Strategjisë së re të Decentralizimit të Republikës së Shqipërisë me aktorët kryesor të pushtetit vendor në vend.

Kjo nisëm erdhi si përgjigje ndaj procesit të udhëhequr nga Qeveria Shqiptare për hartimin e Strategjisë së re të Decentralizimit bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 76, datë 22.4.2022 “Për krijimin e grupit politik ndërinstitucional dhe grupit teknik të punës për hartimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore dhe planin e veprimit të saj, 2023-2030”, si dhe në vijim të shkresës nr. 3459 datë 9.5.2022 të Ministrisë së Brendshme “Kërkesë për përfaqësues”, ku shoqatat e pushtetit vendor janë anëtarë të grupit të punës politiko-teknik të strategjisë së decentralizimit.

Nisma ndihmojë në identifikimin e mangësive, sfidave dhe zgjidhjeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në zbatimin e politikave të decentralizimit dhe funksioneve të qeverisjes vendore. Gjetjet nga këto takime, kontribuojnë në hartimin me pjesëmarrje të rekomandimeve për Strategjinë e Re të Decentralizimit 2023-2030, të cilat gjithashtu do të përfshihen në një dokument publik.

Takimet konsultative ndihmuan në hartimit e vizionit të politikave 2023-2030 i parë nga perspektiva e Njësive të Qeverisjes Vendore, duke identifikuar boshllëqet e politikave dhe ofruar rekomandime për përmirësimin e tyre si dhe masat e propozuara shoqëruar nga objektivat në nivel të mundshëm.

Kjo nisëm mbështetet nga “Bashki të Forta”, një projekt i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, zbatuar në Shqipëri nga HELVETAS.



RRITJA E KAPACITETEVE

#RCDN

Shoqata për Autonomi Vendore ishte pjesë e takimit të organizuar me shoqatat homologe në Ballkanin Perëndimor gjatë muajit tetor 2022 në Shkup, Maqedoni, në kuadër të vazhdimësisë së projektit “Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit (RCDN)”.

Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi dhe mirëkuptimi i përbashkët mbi konceptin, qasjen dhe elementët kyç të projektit RCDN me synim përcaktimin e modaliteteve, prioritetëve si dhe për t’u informuar në lidhje me hapat e mëtejshme.

"Cikli i menaxhimit të trajnimit dhe standardet në ofrimin e trajnimeve", synojnë përmirësimin e kapaciteteve të shoqatave partnere të RCDN për ofrimin cilësor të formateve të zhvillimit të kapaciteteve si "Trajnimet" dhe "Shkëmbimet e Përvojave" sipas standardëve të cilësisë të vendosura nga RCDN.

#Modeli i Menaxhimit të Diversitetit

Bashkë me ekspertët e pushtetit vendor zhvilluam në muajin Shator, Web Seminar-in, mbi “Modelin e Menaxhimit të Diversitetit” të përfshirjes së pakicave dhe grupeve të tjera të cenueshme me synimin përmirësimin e shërbimeve sociale në nivel vendor.



PËRFSHIRJA SOCIALE

#Forumi i Gruas Kryebashkiake

Dhjetor 2022 - Mbahet në Stamboll, "Forumi i Grave Kryetare të Bashkive të Evropës Juglindore", një aktivitet që ka për qëllim shkëmbimin e përvojave të kryebashkiakeve në drejtim të mbështetjes dhe përmirësimit të jetësës për gratë dhe vajzat në komunitetet lokale.

Barazia gjinore nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut, por një nevojë themelore për një botë paqësore, të begatë dhe të qëndrueshme. Ndonëse në dekadat e fundit Shqipëria ka bërë progres në drejtim të barazisë gjinore, ka ende rrugë për të arritur objektivin kryesor të Kombeve të Bashkuar për vitin 2030.

Prej kohësh Shoqata për Autonomi Vendore, në bashkëpunim me aktorë të pushtetit vendor dhe përfaqësues të shoqërisë civile, mbështet këtë objektiv përmes asistencës së bashkive në funksion të orientimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, rritjes së rolit të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse dhe përmirësimit të shërbimeve lokale për grupet e dizavantazuara.

Shoqata për Autonomi Vendore u përfaqësua në këtë aktivitet nga kryebashkiaket dhe nënkryetaret e Bashkive Durrës, Lushnje, Patos, Gjirokastër, Gramsh dhe Drejtoresha Ekzekutive e SHAV.



ZHVILLIMI I BIZNESIT LOKAL

#ADRIONET


Pas takimit të mbajtur në Sloveni, Shoqata për Autonomi Vendore pati nderin të priste Takimin Transnacional të radhës të projektit ADRIONET në Tiranë në datat 16 dhe 17 Nëntor.

Gjatë takimit patëm mundësinë të diskutonim mbi zbatimin e projektit, përditësimin e menaxhimit administrativ financiar, krijimin e një rrjeti transnacional të “fshatrave autentike” dhe Planin e Qëndrueshmërisë pas Projektit.

Në këtë takim bashkë me partnerin kryesor Regione Emilia-Romagna ishin të pranishëm edhe përfaqësues të vendeve të tjera partnere si Borghi Autentici d'Italia, Regionalni razvojni center Koper, Javna ustanova za razvoj Međimurske županije REDEA, Rajoni i Maqedonia Qendrore, Departamenti për Zhvillim dhe Projekte Ndërkombëtare të Kantonit Zenicë-Doboj, dhe RCR Banat.

ADRIONET është një projekt i mbështetur nga programi Interreg ADRIAN i financuar nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal dhe IPA II.

Pas 36 muajsh veprimtari projekti ADRIONET përfundon zbatimin e tij në Janar 2023. Përfitues të këtij projekti përfshinë disa lokalitete rurale në tre bashki të vendit përkatësisht bashkinë Mirëditë, Mat dhe Klos.



MBËSHTETJA KOMUNITARE

#BEpërBASHKITË

Nis thirrja e dytë e projektit "BE për Bashkitë" i cili do të akordojë €600.000 në mbështetje të 13 bashkive për projekte me investime konkrete në infrastrukturë dhe shërbime publike me fokus rininë, arsimin, sportin, kulturën, mbrojtjen sociale, mbrojtjen e mjedisit dhe efikasitetin e energjisë.

BE për Bashkitë është projekt i ri i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga NALAS, pjesë e së cilit është edhe SHAV. Qëllimi tij është të mbështesë potencialin zhvillimor të bashkive dhe të përmirësojë kushtet socio-ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve lokale në Shqipëri. Projekti BE për Bashkitë do të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës vendore duke mundësuar shërbime publike më cilësore dhe zhvillim ekonomik vendor të qëndrueshëm. Projekti do të ndikojë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe perspektivës për qytetarët shqiptarë në komunitetet e tyre.



#ASISTENCE

MJEDISI LOKAL

#Mjedis i Qëndrueshëm Lokal

Bashkëpunimi i të gjithë aktorëve të njësisë vendore për mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit lokal është një domosdoshmëri për ruajtjen dhe zhvillimin e ambientit ku këto komunitete punojnë dhe jetojnë.

SHAV synon ngritjen e kapaciteteve përkatëse njerëzore për mbrojtjen e mjedisit. Kjo përmes, zhvillimit të trajnimeve të specialistëve në pushtetin vendor për zbatimin e ligjit për lejet mjedisore, aspekte të ndryshme të administrimit të mjedisit, ngritjen e grupit të vullnetarëve të mjedisit lokal dhe organizimin e fushatave ndërgjegjësuese me komunitetin.

Në panelin e aktivitetit me temë “Albanian Sustainable Energy Day” forum që nxit diskutime profesionale mbi strategjitë zhvillimore të qëndrueshme në qytetet e vendit si dhe zhvillimin e industrisë së ndërtimeve dhe turizmit, SHAV informoi mbi rolin e saj në mbështjen e bashkive nëpërmjet hartimit të planeve vendore të veprimit mbi efikasitetin e energjisë si dhe të rritjes së kapaciteteve lokale për tërheqjen e fondeve mbi qëndrueshmërinë energjitike.



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Gjatë këtij 6 mujori të fundit SHAV ka marrë pjesë në një sërë takimesh dhe konferencash ndërkombëtare me fokus shkëmbimin e përvojave, tërheqjen e asistencës teknike dhe mbështetjen financiare nga projekte ndërkombëtare në fushën e pushtetit vendor, si dhe kemi ofruar kontributin tonë në hartimin e politikave dhe koordinimin rajonal me homologët e pushtetit vendor.

#Këshilli i Europës

Në muajin tetor u mbajt në Strasburg sesioni i 43-të i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale. Gjatë këtij sesioni u zgjodh dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kongresit, Z. Matheu Mori.

Gjatë takimeve të zhvilluara me autoritetet e lartë të kongresit dhe homologë të kontinentit patëm mundësi të diskutonim për çështje të rëndësishme mbi të ardhmen e Këshillit të Europës dhe rolin e Kongresit.

#Rrjeti Rajonal për Dixhitalizimin

Në konferencën “Partneriteti për një Rajonin Konkurrues” në Dubrovnik ku SHAV mori pjesë në rolin e Sekretariatit Teknik Rajonal si pjesë e Rrjetit #BFC SEE hodhëm hapat për krijimin Rrjeteti Rajonal, që do të nxis bashkëpunimin e qeverive lokale mbi zbatimin dhe përmirësimin e shërbimeve dixhitale. Kryefjala e këtij takimi ishin e-Shërbimet përmes platformave online të bashkive në funksion të lehtësimit të shërbimeve ndaj qytetarit dhe biznesit.





BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

#Menaxhimi i Mbetjeve

Në Selanik ku vizituam impjantin Nordeco, me partnerët e projektit “Waste to Energy” u prezantuam me modelin e bashkë-përpunimit të mbetjeve si Lëndë Djegëse Alternative (LDA) me qëllim përdorimin e kapacitetit termik, në linjë me konceptin e rikuperimit në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve.

Projekti #W2E i zbatuar në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi synon të krijojë parakushtet për prodhimin e lëndëve djegëse alternative nga mbetjet urbane, tekstile dhe të gomës, e më tutje përdorimin e tyre nga industria lokale e prodhimit të çimentos.

#Qytetet Inteligjente

Në "Forum Ekonomik të Qyteteve Inteligjente BE - Ballkani Perëndimor" zhvilluar gjatë muajit nëntor në Pragë diskutuam mbi qytetet inteligjente, agjendën e gjelbër dhe tranzicionin digjital.

Patëm mundësinë që krahas adresimit të nevojave për bashkitë Shqiptare, të njiheshim gjithashtu me politikën e BE për Ballkanin Perëndimor, mjetet financiare për implementimin e projekteve për qytetet e inteligjente dhe strategjitë lokale për zhvillimin e qyteteve.



RAPORTE

Fushata e konsultimit publik zbatuar nga SHAV, me mbështetjen e projektit "Bashki të Forta", në kuadër të hartimit të Strategjisë së re të Decentralizimit të Republikës së Shqipërisë 2023-2030, me aktorët kryesor të pushtetit vendor në vend, prodhojë gjithashtu një sërë rekomandimesh të adresuara nga të 61 bashkitë e vendit dhe përfaqësues të pushtetit vendor. Rekomandimet e përmbledhura do t'i adresohen institucioneve përgjegjëse për hartimin e Strategjisë.

Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore

Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale

Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor

Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor

Rekomandime nga Komisioni i Posacëm i Reformës Administrative Territoriale (2022)

RAPORT

Rekomandime mbi Strategjinë e Re të Decentralizimit 2023 - 2030



Përgatiti:
Shoqata për Autonomi Vendore

ky raport u mbështet nga:



RAPORTE



**Raport Studimor
Performanca e Shërbimeve
Publike të Njësive të
Vetëqeverisjes Vendore**

2020



**#Raporti i Performancës së Shërbimeve
në Nivel Vendor**



#Renta4Bashkitë



25% e Bashkive
zotërojnë në territorin
e tyre pasuri të
mëdha natyrore.



48%
40-48% e licensave aktive
operojnë në këto Bashki

Fatkeqësisht këto bashki
renditen ndër më pak të
zhvilluarat në vend.



#Renta4 Bashkitë R4B



Funded by
the European Union

ANËTARËT



PARTNERËT

Shoqata për Autonomi Vendore, ka për qëllim të llobojë e të jetë një zë i fuqishëm në bazë të politikave e të vizionit të cilat janë paraqitur në statut, për të mbrojtur e monitoruar interesat e anëtarësisë. Ndaj për ne partneriteti dhe bashkëpunimi me shoqatat homologe ndërkombëtare në përftimin e përvojave më të mira europiane dhe rajonale është një domosdoshmëri. Sot, Shoqata operon në partneritet të ngushtë me rrjetet më të rëndësishme të shoqatave lokale të BE dhe Europës Jug-Lindore dhe është një anëtare me të drejta të plota në European Association for Local Democracy.



BASHKË PËR TË ARDHMEN E KOMUNITETIT TONË



*Gëzuar
festat*

